

Informatat mbi Projektin

Emri i Projektit:	"Përmirësimi dhe mbështetja e integritit të pakicave dhe grupeve të marginalizuara, në veçanti grave dhe vajzave të reja në tregun e punës"
Vlera e projektit:	Shuma e përgjithëshme: € 9,976.74
Kohëzgjatja:	Fillimi: 03/08/2020 Përfundimi: 31/01/2021
Organizata implementuese:	Shoqata e Rrobaqepsisë "Bardha"
Kontaktet e Organizatës: Adresa, e-maili, telefonat.	Adresa: Rr. Shaip Spahia, Nr. 45/A, 10 000 Prishtine E-Mail: sh.r.bardha@gmail.com Telefonat: +38349418806
Grupet e synuara:	Ky projekt është përpiluar vetëm për gra dhe vajza nga mosha 15-30 vjeç, përfshirë edhe gra të marginalizuara dhe minoritete . Në procesin e përzgjedhjes, gratë dhe vajzat nga zonat rurale do të favorizohen. Përfitues të drejtëpërdrejtë të programit do të jenë 25 gra dhe vajza, nga mosha 15-30 vjeç, nga Prishtina dhe rrethina (përfshirë Obiliqin dhe Fushë Kosovën) me fokus në zonat rurale.
Partnerët:	Nuk ka
Territori i synuar/shtrirja gjeografike:	Prishtina dhe rrethina (përfshirë Obiliqin dhe Fushë Kosovën) me fokus në zonat rurale.
Qëllimi i përgjithshëm:	Ky projekt synon adresimin e mungesës së njohurive dhe qasjen në informata që gratë i kanë lidhur me të drejtat e tyre socio-ekonomike, se si të kërkojnë në mënyrë të duhur mundësi punësimi, të rrisin njohuritë e tyre për të drejtat e tyre në vendin e punës. Projekti synon t'i arrijë këto përmes dy komponentëve ato teknike dhe të aftësive të buta. Programi trajnues i aftësive teknike do të fokusohet në trajnimin me punë praktike (për të zgjeruar kontakte dhe për të rritur përvojën e grave të cilat janë duke kërkuar punë) dhe për të siguruar angazhimin e fuqishëm të punëdhënësit (që të mund të minimizohet diskriminimi). Programi trajnues i aftësive të buta do të përqëndrohet të ndihmojë gratë në qasjen e patundshmërive (toke), kredi dhe udhëzime të dobishme, duke forcuar aftësitë e buta (p.sh., vetë-respekt, këmbëngulje) dhe zgjerimin e rrjeteve sociale (p.sh., përmes mentorimit, qasjes në shoqatat e biznesit, etj)
Aktivitetet kryesore:	<ul style="list-style-type: none"> - Dizajnimi i programit - Promovimi i programit - Rekrutimi & përzgjedhja e pjesëmarrësve - Dhënja e komponentës teknike - Dhënja e komponentës së aftësive të buta - Ceremonia përmbyllëse & tryeza e rumbullakët
Rezultatet e pritura:	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e ndërgjegjësimit të grave për statusin e tyre socio-ekonomik - Ulja e ekonomisë jo-formale duke inkurajuar pjesëmarrjen e grave në ekonominë formale - Inkurajimi i pjesëmarrjes së grave në tregun e punës - Thyerja e stereotipit që gratë janë të kualifikuara vetëm për të zotëruar biznese të vogla

- Stimulimi i bashkëpunimit dhe rrjetëzimit të grave në biznes, si dhe punëdhënësve të mundshëm
- Rritja e vetëdijes për konceptin e punës me dinjitet dhe të drejtat e punëtorëve
- Punësimi i të paktën 25% e pjesëmarrësve në 2 fabrika të tekstilit, me të cilët "Bardha" ka bashkëpunuar paraprakisht